

## FTESË PËR OFERTË

<b>Organizata:</b>	<b>HANDIKOS</b> (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
<b>Titulli i kontratës:</b>	Kontratë për shërbime turistike
<b>Lokacioni:</b>	Tiranë
<b>Data e publikimit:</b>	16/12/2021
<b>Data e mbylljes:</b>	21/12/2021
<b>Data e vlerësimit të ofertave</b>	22/12/2021
<b>Adresa:</b>	Veternik, rr. "Nekibe Kelmendi", 10000, Prishtinë
<b>Email-i:</b>	<a href="mailto:handikos@handi-kos.org">handikos@handi-kos.org</a>

### 1. PËRMBLEDHJE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (tani e tutje HANDIKOS), është organizatë jo-qeveritare e zhvillimit shoqëror, e themeluar në vitin 1983, duke synuar arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri. Për nevoja të implementimit të aktiviteteve të ndryshme gjatë zbatimit të projekteve, HANDIKOS është duke kërkuar një kompani/agjension për kontraktimin e shërbimeve hotelierike. Të gjithë ofertuesit duhet të përfshijnë këto shërbime:

- Akomodimi për person me konceptin:
  - Half Board- Mengjes dhe dreke (ju lutem specifikoni cka përfshihet), dhe
  - Full Board (ju lutem specifikoni cka përfshihet)
- Salla e trajnimeve e përshtatshme për deri 20 persona:
  - Pako gjysmë ditore
  - Pako tërë-ditore
- Ujë për pjesëmarrës përgjatë trajnimit/punëtorisë;
- Kafe për pjesëmarrës përgjatë pauzave;
- Transporti Kosovë-Tiranë dhe anasjelltas për rreth 20 persona;

### 2. KRITERET PËR APLIKIM

Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë këto kritere:

- Oferta të përfshijë hotele që ndodhen në Tiranë;
- Hotelet e propozuara duhet të kenë qasje fizike për personat me aftësi të kufizuara (e preferueshme tualet për personat me aftësi të kufizuara);
- Hotelet e propozuara duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme në sallën e trajnimeve, që siguron akomodimin e deri 20 personave duke respektuar distancën fizike;
- Hotelet e propozuara duhet të kenë projektor dhe tabelë për shënime;

### 3. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE:

Kriteret për përzgjedhjen e ofertave më të përshtatshme për shërbimet e nevojshme janë:

- Përbushja e kriterëve për aplikim;
- Çmimi më i lirë;

### 4. KOHËZGJATJA E KONTRATËS DHE KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet vetëm pas pranimit të shërbimit, përmes transferit bankar në monedhën e faturimit dhe do të bëhet deri 30 ditë pas marrjes së faturës dhe pranimit të shërbimit. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 1 vit, me mundësi vazhdimi.

### 5. DOKUMENTET PËR DORËZIM DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit;
- Çmimet e shërbimeve në euro duke mos përfshirë TVSH-në (HANDIKOS është e liruar nga TVSH prandaj çmimet duhet të jenë pa TVSH);
- Oferta financiare e ndarë me cmime për: akomodim Half Board, akomodim Full Board, Salla e takimeve, dhe transporti;
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur/apo me llogo zyrtare;
- Vërtetimi tatimor (pas përzgjedhjes);
- Certifikata e gjendjes penale e personit të autorizuar (pas përzgjedhjes).

### 6. UDHËZIM PËR OFERTUESIT

Ofertuesit janë të mirëpritur të dorëzojnë aplikacionet e tyre për shërbime turistike në [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org), me mbishkrimin: “Oferta për shërbime turistike”, më së voni deri më 21/12/2021 në mesnatë. Propozimet e marra pas afatit të caktuar nuk do të merren në konsideratë.

Kjo ofertë është e hapur për të gjitha kompanitë/agjensionet që janë të konstituara ligjërisht dhe mund të ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.